

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE TRANSPORTIT	
MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE I TRANSPORTA	
MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND TRANSPORTATION	
Nr. i Prot. / Org. Jedinita / Org. Unit	7416
Nr. i Faqe / Br. Stranica / No. Pages	02 e sht
PRISHTINE/A	



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS	
MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE	
MINISTRY OF INFRASTRUCTURE	
Nr. i Prot. / Broj Prot. / Prot. No.	488/19
Data / Datum / Date	11.07.19
HTINE/A	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria Infrastrukturës dhe Transportit
Ministarstvo Infrastrukture i Transporta
Ministry of Infrastructure and Transportation

Ministri Infrastrukturës dhe Transportit, në mbështetje të nenit 145 (paragrafit 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) dhe neni 38 (paragrafi 3) të rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës të Kryeministrit dhe Ministrave (22.03.2011), Rregulloren nr. 26/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 02/2011 Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës të Kryeministrit dhe Ministrave, nenit 84 dhe 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazta Zyrtare Nr. 20/21 Qershor 2016), nenit 5 dhe 21 Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, Udhëzimin Administrativ 06/2016 për plotësimin e udhëzimit administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendit të udhëtimit të transportit ndër urban të udhëtarëve me autobus, dhe rekomandimit të komisionit të caktuar me vendimin nr.5517 të dt.23.05.2019, nxjerr këtë:

VENDIM

Refuzohet ankesa nr. prot. 4336 të dt. 24.04.2019 dhe nr. prot. 5158 të dt. 15.05.2019 e parashtruar nga operatori transportues "XXL Travel" Sh.p.k nga Peja, ndaj vendimit nr.4156 të dt.19.04.2019 dhe vendimit nr.4146 të dt.10.05.2019 për refuzimin e kërkesës për marrjen e nisjes në relacionin Junik-Deçan-Pejë-Prishtinë, për nisjen në ora 18:15 me kthim në ora 21:00.

Arsyetim

Komisionit i emëruar nga Ministri Infrastrukturës dhe Transportit, me vendimin nr. prot. 5517 të datës: 23.05.2019, pas shqyrtimit të ankesës nr. prot. 4336 të dt. 24.04.2019 dhe nr. prot. 5158 të dt. 15.05.2019 e parashtruar nga operatori transportues "XXL Travel" Sh.p.k nga Peja, ndaj vendimit nr. 4156 të dt. 19.04.2019 dhe vendimit nr. 4146 të dt. 10.05.2019 për refuzimin e kërkesës për marrjen e nisjes në relacionin Junik - Deçan - Pejë - Prishtinë, për nisjen në ora 18:15 me kthim në ora 21:00, dhe pas vlerësimit të dosjes të aplikimit, kushteve për aplikim në shpalljen publike dhe procesverbalit nr.2161 të dt.11.03.2019 të komisionit të caktuar nga Ministri Infrastrukturës dhe Transportit me vendimin nr. prot. 2259/18 të datës 06.03.2019 për vlerësimin e aplikacionit, ka konstatuar se komisioni i caktuar nga Ministri Infrastrukturës dhe Transportit me vendimin nr. prot. 2259/18 të datës 06.03.2019, vlerësojmë se komisioni ka bërë vlerësim të drejtë të aplikacionit, kështu që operatori në fjalë nuk i ka plotësuar kushtet sipas pikës (4) të shpalljes publike nr.1643 dt. 21.02.2019 dhe paragrafit (1) nën paragrafi 1.8 të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërurban të

udhëtarëve me autobus i cili kriter është dhënë edhe në shpjegimin për mënyrën e aplikimit në shpalljen publike nr.1643 dt. 21.02.2019, pasi që i njëjti në dosje të aplikimit ka prezantuar rendin e udhëtimit ku koha e kthimit, stacioni i kthimit dhe vende ndaljet në rendin e udhëtimit nuk janë të formatit të kërkuar, gjegjësisht janë të formatit të gabuar.

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë vendimi është marrë si në dispozitiv dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroi pari në Gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës të Sekretarit të Përgjithshëm;
- Parashtruesit të kërkesës;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Zyrës së Arkivit të MI -së.

